


STRATEGJIA

2026–2031



Mitrovica Veriore
Korrik 2026

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	3
2. Metodologjia dhe procesi i zhvillimit të strategjisë	5
3. Analiza e kontekstit	7
4. Identiteti organizativ	16
5. Qëllimet strategjike	19
6. Zhvillimi i kapaciteteve organizative	33
7. Monitorimi, vlerësimi dhe të mësuarit organizativ (MEL)	36
8. Komunikimi dhe dukshmëria strategjike	40
9. Qëndrueshmëria financiare dhe mobilizimi i burimeve	42
10. Zbatimi, monitorimi dhe rishikimi periodik i strategjisë	45



1. HYRJE

1.1. Rreth ACDC-së

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) është një organizatë e shoqërisë civile me seli në Mitrovicën Veriore, e themeluar në vitin 2011. Organizata filloi punën në mjedisin specifik politik, institucional dhe shoqëror të veriut të Kosovës, me qëllim që të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, avancimin e sundimit të ligjit, zhvillimin e kulturës demokratike dhe ndërtimin e një shoqërie të hapur, tolerante dhe paqësore në Kosovë. Gjatë veprimtarisë së saj, ACDC ndërtoi gradualisht profilin e një organizate që ndërlidh punën kërkimore dhe analitike me avokimin publik, bashkëpunimin me institucionet dhe punën e drejtpërdrejtë me qytetarët dhe komunitetet lokale.

Selia e organizatës në Mitrovicën Veriore dhe puna shumëvjeçare në komunat në veri të Kosovës kanë përcaktuar që ACDC të ketë një fokus të veçantë në nevojat dhe pozitën e komunitetit serb, funksionimin e institucioneve, ofrimin e shërbimeve publike dhe qasjen në drejtësi në mjediset me shumicë serbe në Kosovë. Megjithatë, veprimtaria e organizatës nuk kufizohet vetëm në veriun e Kosovës. ACDC bashkëpunon me institucionet në nivel lokal dhe qendror, si dhe me organizatat dhe përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme në mbarë Kosovën, duke synuar që përvojat dhe pozita e qytetarëve nga komunitetet joshumicë të bëhen më të dukshme në politikat publike dhe në proceset e vendimmarrjes në një plan më të gjerë.

Sundimi i ligjit përfaqëson një nga fushat më themelore dhe më të njohura të punës së organizatës. ACDC ka monitoruar reformën dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në veri të Kosovës, qasjen në drejtësi, zbatimin e ligjeve, transparencën në punën e institucioneve dhe realizimin e të drejtave gjuhësore dhe të drejtave të tjera të komuniteteve joshumicë. Veprimtaria e organizatës ka vënë theks të veçantë në ndërtimin e një sistemi funksional të sundimit të ligjit në veri të Kosovës dhe në integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komuniteti serb në sistemin e drejtësisë të Kosovës.

Një pjesë e rëndësishme e punës së organizatës lidhet edhe me marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe policisë, si dhe institucioneve të tjera të sigurisë. ACDC ka krijuar hapësirë për dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, nga njëra anë, dhe përfaqësuesve të policisë, nga ana tjetër, lidhur me problemet e sigurisë, besimin dhe transparencën e punës së policisë në veri të Kosovës. Kjo punë pasqyron qasjen karakteristike të organizatës, e cila konsiston në vendosjen e bashkëpunimit me institucionet kur një bashkëpunim i tillë mund të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve, duke ruajtur njëkohësisht gatishmërinë për të vënë në dukje sjelljen e papërshtatshme, përfaqësimin e pamjaftueshëm të komuniteteve ose mosrespektimin e të drejtave të qytetarëve.

Krahas sundimit të ligjit, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, ACDC ka zhvilluar programe në fushat e të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit, proceseve zgjedhore, pjesëmarrjes qytetare dhe aktivizmit, bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, punës me të rinjtë, krijimtarisë kulturore dhe, në periudhën e fundit, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Organizata zhvillon hulumtime, harton analiza profesionale dhe përgatit rekomandime për politika publike, por gjithashtu organizon trajnime, diskutime publike, iniciativa lokale dhe forma të tjera të punës në komunitet. Në këtë mënyrë, ACDC, nga një organizatë kryesisht lokale, zhvilloi gradualisht tiparet e një organizate „think-and-do-tank”, e cila harton propozime për politika publike, por njëkohësisht punon me qytetarët dhe institucionet për zbatimin e tyre në praktikë.

1.2. Vazhdimësia strategjike dhe arsyet për miratimin e një Strategjie të re



Dokumenti aktual përfaqëson strategjinë e tretë të ACDC-së. Strategjia e parë përfshinte periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2020, ndërsa strategjia e dytë përcaktoi drejtimin e zhvillimit të organizatës për periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2026. Strategjitë e mëparshme kanë përcjellë faza të ndryshme të zhvillimit të ACDC-së: nga konsolidimi i strukturës organizative dhe profilizimi i punës në fushën e sundimit të ligjit, përmes zgjerimit të temave programore dhe shtrirjes gjeografike, deri te zhvillimi i rolit kërkimor dhe avokues të organizatës.

Që nga miratimi i strategjisë së mëparshme, kanë ndryshuar ndjeshëm si ACDC, ashtu edhe mjedisi në të cilin vepron. Krizat politike dhe institucionale në veri të Kosovës, ndryshimet në funksionimin e institucioneve lokale, sistemit të drejtësisë dhe policisë, thellimi i mosbesimit ndërmjet komuniteteve joshumicë dhe institucioneve të Kosovës, si dhe ngushtimi i hapësirës për dialog, e kanë rritur më tej rëndësinë e organizatave që, përmes punës së tyre, mund të ndërlidhin përvojat e qytetarëve, analizën profesionale dhe avokimin publik të përgjegjshëm. Në të njëjtën kohë, janë shfaqur edhe nevoja të tjera të komunitetit, si përfshirja më e madhe e të rinjve në jetën publike, përmirësimi i pozitës së grave dhe pjesëtarëve të komunitetit LGBTQI+, rivendosja e kontakteve ndërmjet komuniteteve dhe reagimi ndaj problemeve lokale mjedisore.

ACDC u është përgjigjur këtyre ndryshimeve duke zgjeruar temat, metodat dhe partneritetet e saj. Ky fleksibilitet i ka mundësuar organizatës të reagojë ndaj problemeve të reja dhe të mbetet e pranishme në komunitet gjatë periudhave të ndryshmeve të shpejta politike dhe institucionale. Megjithatë, zgjerimi i punës programore ka ngritur edhe çështjen e koherencës dhe qëndrueshmërisë së saj afatgjatë. Është vërejtur se temat dhe projektet individuale nuk kanë qenë gjithmonë të integruara në mënyrë të mjaftueshme në programe me rezultate të pritshme afatgjata të përcaktuara qartë, ndërsa prioritetet janë formësuar pjesërisht nga interesat dhe prioritetet e disponueshme të donatorëve.

Financimi përmes projekteve mbetet parakushti themelor për punën e një organizate të shoqërisë civile si ACDC. Prandaj, sfida nuk qëndron te bashkëpunimi me donatorët apo te përshtatja e projekteve me kushtet e financimit, por te krijimi i një ekuilibri ndërmjet nevojave të komuniteteve dhe pritshmërive të donatorëve. Në periudhën e ardhshme, ACDC synon që fillimisht të përcaktojë më qartë problemet dhe ndryshimet që i konsideron prioritare për qytetarët dhe komunitetet me të cilat punon, e më pas të kërkojë partnerë dhe burime të përshtatshme mbështetjeje për programet e përcaktuara në këtë mënyrë.

Strategjia e re u përgjigjet edhe nevojave për zhvillimin e brendshëm të organizatës. Rritja e vëllimit dhe shumëllojshmërisë së punës ka shtuar ngarkesën e ekipit dhe ka nxjerrë në pah nevojën për një ndarje më të qartë të roleve, koordinim më të mirë të aktiviteteve dhe menaxhim më sistematik të kujtesës institucionale dhe njohurive të organizatës. Në të njëjtën kohë, rezultatet e projekteve të ndryshme janë monitoruar kryesisht në përputhje me kërkesat e donatorëve individuale, për këtë arsye nuk ka qenë gjithmonë e mundur që ato të integrohen dhe të paraqitet në mënyrë të besueshme kontributi më i gjerë i ACDC-së në ndryshimet brenda komunitetit, në praktikat institucionale dhe në politikat publike.

Për këtë arsye, zhvillimi i një sistemi funksional të monitorimit, vlerësimit dhe të nxënies organizativ, përmirësimi i komunikimit, menaxhimi më optimal i burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe diversifikimi i burimeve të financimit, përbëjnë pjesë integrale të kësaj strategjie. Ato nuk janë një shtesë administrative ndaj qëllimeve programore, por kushte që i mundësojnë organizatës ta përmbushë misionin e saj në mënyrë më të qëndrueshme.

1.3. Qëllimi dhe drejtimi i Strategjisë

Strategjia e re mbështetet në identitetin ekzistues organizativ të ACDC-së dhe i ndërlidh më qartë fushat e deritanishme të punës brenda një kuadri të përbashkët strategjik. Përvoja e organizatës tregon se



problemet me të cilat përballen qytetarët në Kosovë, veçanërisht në veri të Kosovës dhe në mjediset e tjera ku jetojnë komunitetet joshumicë, shpesh janë të ndërlidhura dhe kërkojnë një qasje të integruar.

Qasja në drejtësi në veri të Kosovës nuk varet vetëm nga ligjet, por edhe nga fakti nëse qytetarët i kuptojnë procedurat, mund ta përdorin gjuhën e tyre dhe kanë besim se institucionet do t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë. Marrëdhëniet me policinë dhe sistemin e drejtësisë rëndohen nga krizat politike, ndryshimet në përfaqësimin e komunitetit serb dhe mosbesimi afatgjatë. Aktivizmi qytetar kufizohet nga polarizimi politik dhe perceptimi se vendimet merren pa ndikimin e mirëfilltë të komuniteteve lokale. Për këtë arsye, ACDC e ndërlidh bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve me zgjidhjen e problemeve konkrete, duke përfshirë çështjet mjedisore, ndërsa përfshirjen sociale e trajton përtej përkatësisë etnike, në mënyrë që të përfshijë pozitën e grave, pjesëtarëve të komunitetit LGBTQI+, të rinjve dhe grupeve të tjera të cënueshme. Problemet mjedisore i ndërlidhin më tej cilësinë e jetës, përgjegjësinë institucionale dhe aktivizmin lokal.

Prandaj, strategjia nuk e organizon punën e ardhshme të ACDC-së si një tërësi temash të palidhura, por përmes pesë qëllimeve strategjike të ndërlidhura:

1. përmirësimi i sundimit të ligjit, qasjes në drejtësi dhe llogaridhënies së institucioneve;
2. nxitja e qytetarisë aktive, me fokus të veçantë në pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike dhe në vendimmarrje;
3. forcimi i bashkëpunimit, dialogut, besimit të ndërsjellë dhe pjesëmarrjes së barabartë të komuniteteve dhe grupeve të ndryshme shoqërore;
4. promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të përgjegjshëm të mjedisit dhe burimeve lokale;
5. zhvillimi i kapaciteteve organizative dhe qëndrueshmërisë së ACDC-së..

Katër qëllimet e para lidhen me ndryshimet shoqërore dhe institucionale në të cilat ACDC synon të kontribuojë, ndërsa qëllimi i pestë përcakton kapacitetet, sistemet dhe burimet që organizata duhet t'i zhvillojë në mënyrë që ky kontribut të jetë më i qëndrueshëm.

Ndryshimi themelor që sjell strategjia nuk është kalimi nga një grup temash në një grup tjetër, por kalimi nga planifikimi kryesisht i bazuar në projekte drejt një qasjeje programore më afatgjatë. Hulumtimet, analizat, avokimi publik, trajnimet, dialogu dhe iniciativat lokale nuk do të trajtohen si rezultate në vetvete, por si instrumente për realizimin e ndryshimeve të përcaktuara më qartë.

Strategjia do të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve programore, zhvillimin e projekteve dhe partneriteteve të reja, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe monitorimin e rezultateve të punës. Qëllimi i saj është t'i mundësojë ACDC-së të ruajë aftësinë për të reaguar shpejt ndaj ndryshimeve në Kosovë, por njëkohësisht ta vendosë këtë fleksibilitet në funksion të realizimit të prioritetëve afatgjatë, me përgjegjësi të qartë ndaj qytetarëve dhe komuniteteve me të cilat punon.

2. METODOLOGJIA DHE PROCESI I ZHVILLIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia e ACDC-së u zhvillua përmes një procesi pjesëmarrës të planifikimit strategjik, i cili zgjati nga prilli deri në korrik të vitit 2026. Në këtë proces u përfshinë përfaqësuesit e organizatës, të cilët analizuan së bashku zhvillimin e deritanishëm të ACDC-së, kapacitetet e brendshme, ndryshimet në mjedisin e jashtëm dhe nevojat e komuniteteve me të cilat punon organizata.



Qëllimi i procesit nuk ishte vetëm hartimi i një dokumenti të ri strategjik, por edhe krijimi i një kuptimi të përbashkët se cilat ndryshime shoqërore dhe institucionale dëshiron të promovojë ACDC në periudhën e ardhshme dhe cilat kapacitete organizative duhet të zhvillojë për të kontribuar në arritjen e këtyre qëllimeve.

Procesi përfshiu anketimin paraprak të përfaqësuesve të organizatës, dy sesione fillestare pune në Mitrovicën Veriore, punën intensive disa ditore në Durrës, si dhe hartimin dhe rishikimin e mëvonshëm të draftit të strategjisë përmes konsultimeve me përfaqësuesit e organizatës.

2.1. Qasja metodologjike dhe fazat e procesit

Planifikimi strategjik u konceptua si një proces pjesëmarrës, bashkëpunues dhe i zhvilluar në faza, i cili ndërthuri vlerësimet individuale, analizën në grup, diskutimin e strukturuar dhe vendimmarrjen e përbashkët.

Procesi filloi me anketimin paraprak dhe sesionet fillestare kushtuar vlerësimit të pozitës aktuale të organizatës, fokusit të saj programor, gjerësisë së fushave të veprimtarisë, rezultateve të mëparshme dhe kapaciteteve në dispozicion. Në mënyrë të veçantë u shqyrtuan marrëdhëniet ndërmjet fokusit programor dhe gjerësisë së veprimtarisë, misionit të organizatës dhe mundësive të ofruara nga donatorët, si dhe ambicieve të ACDC-së dhe kapaciteteve të nevojshme për realizimin e tyre.

Në fazën pasuese u rishqyrtuan misioni, vizioni dhe vlerat organizative, pas së cilës u zhvillua analiza e palëve të interesuara, e mjedisit politik dhe institucional, e fuqive dhe dobësive të brendshme, si dhe e mundësive dhe rreziqeve për zhvillim. Kjo pjesë e procesit u zhvillua përmes punës me përfaqësuesit e organizatës në Mitrovicën Veriore dhe në Durrës gjatë prillit dhe majit të vitit 2026.

Në bazë të gjetjeve dhe përfundimeve të mbledhura u hartua drafti i Strategjisë, në kuadër të të cilit u përcaktuan qëllimet strategjike dhe specifike, detyrat strategjike, rezultatet e pritshme dhe prioritetet e zhvillimit organizativ. Procesi i hartimit të draftit u shoqërua me konsultime online gjatë majit dhe qershorit të vitit 2026, ndërsa shqyrtimi dhe rishikimi përfundimtar i draftit u realizuan në korrik të vitit 2026 në Mitrovicën Veriore.

2.2. Nga analiza te prioritetet strategjike

Qëllimet strategjike nuk u përcaktuan si një listë e projekteve ekzistuese apo e temave për të cilat ka financim në dispozicion. Procesi u përqendrua në shqyrtimin e ndryshimeve të synuara, në të cilat ACDC dëshiron të kontribuojë në punën e institucioneve dhe në politikat publike, përkatësisht në pozitën e qytetarëve dhe komuniteteve.

Hulumtimet, analizat profesionale, avokimi publik, programet arsimore, dialogu dhe iniciativat lokale u trajtuan si mënyra për arritjen e qëllimeve dhe jo si qëllime në vetvete.

Krahas prioritetëve programore, u analizuan struktura organizative, burimet njerëzore, komunikimi, menaxhimi i burimeve financiare dhe teknike, mbledhja e fondeve dhe sistemi i monitorimit, vlerësimit dhe mësimi organizativ (MEL – Monitoring, Evaluation and Learning).

2.3. Sistematizimi dhe validimi



Rezultatet e të gjitha fazave u sistematizuan dhe u integruan në draftin e strategjisë. Më pas, drafti u shqyrtua dhe u rishikua në konsultim me ACDC-në. Vëmendje e veçantë iu kushtua që strategjia:

- të pasqyrojë identitetin dhe përvojën reale të organizatës;
- të ruajë një raport realist ndërmjet ambicieve programore dhe kapaciteteve organizative;
- të krijojë një lidhje më të qartë ndërmjet qëllimeve strategjike, projekteve të ardhshme dhe burimeve në dispozicion.

Në këtë mënyrë, Strategjia u zhvillua si një dokument i përbashkët organizativ, i mbështetur në përvojën e ACDC-së, në analizën e strukturuar dhe në idetë që përfaqësuesit e organizatës i formësuan bashkërisht.

3. ANALIZA E KONTEKSTIT

Orientimi strategjik i ACDC-së bazohet në vlerësimin e mjedisit të jashtëm, marrëdhënieve me palët kryesore të interesuara dhe kapaciteteve të brendshme të organizatës. Këto tri dimensione ndikojnë drejtpërdrejt në përzgjedhjen e prioriteteve, mënyrën e punës dhe mundësitë reale të ACDC-së për të kontribuar në ndryshimet në komunitet dhe shoqëri, si dhe në institucione dhe politikat publike në Kosovë.

Konteksti i veriut të Kosovës ka rëndësi të veçantë, ku ndryshimet politike, juridike, të sigurisë dhe shoqërore ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve, pozitën e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë, funksionimin e institucioneve dhe hapësirën për veprimin e shoqërisë civile. Në rrethana të tilla, ACDC duhet njëkohësisht ta ruajë aftësinë për t'u përshtatur, ta ruajë fokusin programor dhe të zhvillojë marrëdhënie me qytetarët, institucionet dhe partnerët që mundësojnë ndikim më afatgjatë.

3.1. Mjedisi i jashtëm

Për vlerësimin e mjedisit të jashtëm është përdorur analiza e faktorëve politikë, ekonomikë, shoqërorë, teknologjikë, juridikë dhe mjedisorë (analiza PESTLE). Qëllimi ishte të identifikonte ndryshimet dhe trendet që mund ta mbështesin ose kufizojnë punën e ACDC-së gjatë periudhës së ardhshme strategjike.

Mjedisi politik dhe institucional

Mjedisi politik në Kosovë mbetet i paqëndrueshëm dhe në masë të konsiderueshme varet nga marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe procesi i dialogut, si dhe nga ciklet zgjedhore në Kosovë dhe ndryshimet në funksionimin e institucioneve. Në veri të Kosovës, këto ndryshime kanë pasoja të drejtpërdrejta për administratën komunale, policinë, sistemin e drejtësisë, ofrimin e shërbimeve publike dhe përfaqësimin politik të komunitetit serb.

Çështje me rëndësi të veçantë lidhen me përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve në organet e pushtetit, riintegrimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në institucione, duke përfshirë policinë dhe



sistemin e drejtësisë, besimin e përgjithshëm të qytetarëve në punën e institucioneve, si dhe perspektivat e formimit të Bashkësisë/Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Pasiguria e zgjatur politike zvogëlon gatishmërinë e qytetarëve për pjesëmarrje dhe vështirëson bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve.

Në një mjedis të tillë, ACDC ka hapësirë për t'i ndërlidhur përvojat e qytetarëve me politikat publike, për të hapur dialogun mbi problemet institucionale dhe për të monitoruar pasojat e vendimeve politike dhe administrative për pozitën e komuniteteve joshumicë. Në të njëjtën kohë, organizata duhet të marrë parasysh rrezikun e trazirave politike dhe ta ruajë pavarësinë e saj në raport me institucionet, partitë politike dhe akterët ndërkombëtarë.

Mjedisi juridik

Korrniza ligjore e Kosovës përmban garanci të rëndësishme në fushat e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve, përdorimit të gjuhëve zyrtare, qasjes në drejtësi dhe pjesëmarrjes së komuniteteve. Megjithatë, një nga problemet kryesore mbetet hendeku ndërmjet zgjidhjeve ligjore dhe zbatimit të tyre.

Interpretimi dhe zbatimi selektiv i ligjeve, miratimi jotransparent i rregulloreve, procedurat e ndërlikuara dhe veprimi jo i njëtrajtshëm i institucioneve i prekin veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Qytetarët shpesh nuk kanë informacione të mjaftueshme për të drejtat e tyre, kompetencat e institucioneve dhe mekanizmat e disponueshëm të mbrojtjes.

Për këtë arsye, për ACDC, do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm monitorimi jo vetëm i përmbajtjes së ligjeve, por edhe i zbatimit të tyre praktik në Mitrovicën Veriore, në komunat e tjera në veri të Kosovës dhe në mjediset ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë.

Mjedisi shoqëror

Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve vazhdojnë të rëndohen nga tensionet politike, trashëgimia e luftës, barrierat gjuhësore dhe kontaktet e kufizuara të përditshme. Një sfidë e veçantë paraqet marrëdhënia ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar, por edhe pozita e komuniteteve të tjera joshumicë.

Konteksti shoqëror formësohet edhe nga niveli i ulët i besimit në institucione, pjesëmarrja e dobët e qytetarëve, përfaqësimi i pamjaftueshëm i grupeve të caktuara dhe largimi i të rinjve. Migrimi, veçanërisht i të rinjve të arsimuar dhe aktivë, zvogëlon kapacitetet e komuniteteve lokale dhe dobëson më tej hapësirën për veprim qytetar.

Gratë, pjesëtarët e komunitetit LGBTQI+ dhe grupet e tjera të marginalizuara përballen me pengesa shtesë, duke përfshirë dukshmërinë e kufizuar, mbështetjen e pamjaftueshme institucionale dhe hapësirën e ngushtuar për pjesëmarrje publike.

Për ACDC, kjo do të thotë se bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve, përfshirja sociale, puna me të rinjtë dhe qytetaria aktive duhet të mbeten të ndërlidhura dhe jo të trajtohen si drejtime të ndara programore.

Mjedisi ekonomik dhe i donatorëve

Papunësia, pasiguria ekonomike dhe migrimi përbëjnë sfida të vazhdueshme për komunitetet lokale. Zbatimi selektiv i rregulloreve dhe paqëndrueshmëria politike i ngadalësojnë më tej aktivitetet ekonomike, zvogëlojnë investimet dhe kufizojnë zhvillimin e sipërmarrjes lokale.

Në të njëjtën kohë, organizatat e shoqërisë civile përballen me zvogëlimin e fondeve, financimin afatshkurtër përmes projekteve dhe ndryshimin e vazhdueshëm të prioriteteve të donatorëve. Një model i



tillë e rrit pasigurinë financiare dhe mund t'i nxisë organizatat që programet t'ua përshtatin thirrjeve të disponueshme për projekte, në vend që t'i zhvillojnë ato duke u bazuar në misionin e tyre dhe nevojat e komuniteteve.

Për këtë arsye, për ACDC-në është e rëndësishme t'i diversifikojë burimet e financimit, të zhvillojë kontakte me donatorë të rinj, të forcojë kapacitetet për përgatitjen e projekteve më të mëdha dhe më afatgjata dhe të rrisë gradualisht pjesën e financimit institucional dhe më fleksibil.

Mjedisi teknologjik dhe mediatik

Inteligjenca artificiale, mjetet digjitale, rrjetet sociale dhe puna në distancë krijojnë mundësi të reja për hulumtime, komunikim, trajnime dhe menaxhim të projekteve. Ato mund ta rrisin efikasitetin e punës dhe ta lehtësojnë përfshirjen e qytetarëve nga mjedise të ndryshme.

Në të njëjtën kohë, njohuritë e pamjaftueshme për teknologjitë e reja, përhapja e dezinformatave dhe rreziqet që lidhen me ruajtjen e të dhënave paraqesin sfida serioze. Në një mjedis të polarizuar politikisht, dezinformatat dhe fushatat negative mediatike mund t'i dëmtojnë më tej marrëdhëniet ndëretnike dhe të rrezikojnë besimin, sigurinë e pjesëmarrësve dhe reputacionin e organizatës. Për këtë arsye, ACDC do të investojë në kapacitetet digjitale, sigurinë e të dhënave, verifikimin e informacioneve dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të reja.

Mjedisi ekologjik

Mbrojtja e mjedisit po bëhet një temë gjithnjë e më e rëndësishme për komunitetet lokale. Në veri të Kosovës janë veçanërisht të theksuara problemet e ndotjes së ajrit, gjendjes së pellgut të lumit Ibër, deponive ilegale dhe rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore.

Në të njëjtën kohë, komunitetet lokale shpesh nuk kanë kapacitete të mjaftueshme profesionale, informacione apo mjete financiare për t'iu përgjigjur në mënyrë sistematike këtyre problemeve. Zvogëlimi i fondeve për aktivitete konkrete në terren i kufizon më tej mundësitë për ndërhyrje ekologjike më afatgjata.

Për ACDC-në, mjedisi përfaqëson njëkohësisht një fushë të interesit publik dhe një hapësirë për ndërlidhjen e pjesëmarrjes qytetare, përgjegjësisë së institucioneve dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve.

Implikimet kryesore të mjedisit të jashtëm

Në periudhën e ardhshme, ACDC duhet:

- të monitorojë ndryshimet politike, juridike dhe institucionale që ndikojnë në veriun e Kosovës dhe komunitetin serb;
- ta ruajë fleksibilitetin për reagim ndaj krizave pa e humbur fokusin strategjik;
- të zhvillojë bashkëpunim kritik, por konstruktiv me institucionet;
- ta ndërlidhë analizën juridike dhe politike me përvojat e qytetarëve;
- të investojë në punën me të rinjtë, pjesëmarrjen qytetare dhe përfshirjen sociale;
- të forcojë kapacitetet digjitale dhe qëndrueshmërinë ndaj dezinformatave;
- të zhvillojë burime më të qëndrueshme financimi;



- t'i ndërlidhë çështjet mjedisore me aktivizmin lokal dhe përgjegjësinë e institucioneve.

3.2. Analiza e palëve të interesuara

ACDC e përmbush misionin e saj përmes marrëdhënieve me qytetarët, komunitetet, institucionet, organizatat e shoqërisë civile, mediat, ekspertët, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët. Këta akterë kanë nivele të ndryshme interesi, ndikimi dhe ndërlidhjeje me punën e organizatës.

Analiza e palëve të interesuara u realizua përmes ushtrimeve “rrethi i përfshirjes” dhe “matrica e ndikimit dhe interesit”. Në këtë mënyrë u dalluan përfituesit e drejtpërdrejtë, partnerët e drejtpërdrejtë, akterët institucionalë me ndikim dhe mjedisi më i gjerë në të cilin vepron ACDC.

Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe komunitetet

Në fokusin e drejtpërdrejtë të ACDC-së janë qytetarët, veçanërisht:

- të rinjtë, duke përfshirë vullnetarët dhe aktivistët e rinj;
- komuniteti serb dhe komunitetet e tjera joshumicë;
- komunitetet lokale në veri të Kosovës;
- grupet e marginalizuara dhe të nënpërfaqësuar;
- gratë;
- komuniteti LGBTQI+;
- qytetarët që kanë nevojë për qasje në informacione juridike dhe institucionale.

Këto grupe nuk duhet të konsiderohen vetëm si përfitues të aktiviteteve, por edhe si partnerë në identifikimin e problemeve, zhvillimin e iniciativave dhe vlerësimin e rezultateve të punës së organizatës.

Partnerët kryesorë

Ndër akterët me nivel të lartë interesi dhe ndikim të konsiderueshëm janë:

- organizatat lokale dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile;
- organizatat ndërkombëtare;
- policia;
- institucionet e drejtësisë;
- ekspertët e jashtëm;
- institucionet lokale;
- organizatat që ofrojnë ndihmë juridike falas.

Bashkëpunimi me policinë dhe sistemin e drejtësisë është veçanërisht i rëndësishëm, sepse këto institucione janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë, qasjen në drejtësi dhe besimin e qytetarëve. Në të



njëjtën kohë, ky bashkëpunim mbart rreziqe politike dhe rreziqe për reputacionin, prandaj duhet të bazohet në parime të qarta të pavarësisë, transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Akterët institucionalë

Institucionet lokale dhe qendrore kanë nivel të lartë ndikimi në temat me të cilat merret ACDC, por niveli i interesit të tyre për bashkëpunim nuk është gjithmonë i njëjtë.

Ndër akterët e rëndësishëm institucionalë bëjnë pjesë:

- komunat dhe strukturat komunale;
- degët lokale të institucioneve qendrore;
- organet e pushtetit qendror;
- ministritë përkatëse;
- institucionet e drejtësisë;
- policia;
- Zyra e Komisionerit për Gjuhët;
- Institucioni i Avokatit të Popullit;
- Zyra për Qeverisje të Mirë.

ACDC do të bashkëpunojë me institucionet kur ekziston hapësirë për ndryshime konkrete, por njëkohësisht do ta monitorojë punën e tyre dhe do ta ruajë të drejtën për kritikë publike dhe avokim për llogaridhënie.

Shoqëria civile, mediat dhe publiku profesional

Organizatat lokale të shoqërisë civile nga komuniteti serb dhe ai shqiptar, si dhe organizatat rajonale, përbëjnë një pjesë të rëndësishme të rrjetit të partnerëve të ACDC-së. Ato mund të kontribuojnë në qasjen te komunitetet, shkëmbimin e njohurive, ndërlidhjen rajonale dhe avokimin e përbashkët.

Mediat kanë rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve dhe prezantimin e rezultateve të organizatës, por niveli i interesit dhe cilësia e bashkëpunimit të tyre ndryshojnë. Mediat qendrore kanë ndikim më të madh, ndërsa mediat lokale shpesh kanë interes më të madh për tema konkrete që lidhen me komunitetin.

Qendrat kulturore, institucionet arsimore, studiuesit dhe ekspertët e jashtëm mund të kontribuojnë në programet e dialogut, edukimit, kulturës dhe analizave profesionale.

Donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë

Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët kanë nivel të lartë ndikimi në qëndrueshmërinë financiare të ACDC-së, por edhe në mjedisin më të gjerë politik dhe institucional.

Ndër akterët përkatës janë identifikuar Bashkimi Evropian, UNMIK-u, IOM-i, ambasadat, fondacionet ndërkombëtare dhe agjencitë ndërkombëtare.



ACDC do të synojë zhvillimin e marrëdhënieve me donatorët që shkojnë përtej cikleve individuale të projekteve. Organizata do t'u prezantojë atyre nevojat e komuniteteve, ndryshimet në kontekstin lokal dhe prioritetet e veta programore më afatgjata, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë në përzgjedhjen e temave dhe partneriteteve.

Akterët e tjerë

Në mjedisin më të gjerë përfshihen edhe aktorët e mëposhtëm:

- komuniteti shumicë;
- misionet ndërkombëtare politike dhe të sigurisë;
- sektori privat;
- partitë politike;
- institucionet arsimore;
- rrjetet rajonale.

Këta aktorë nuk është e domosdoshme të përfshihen çdo ditë në punën e ACDC-së, por mund të ndikojnë ndjeshëm në kontekstin shoqëror, disponueshmërinë e burimeve dhe mundësitë për realizimin e qëllimeve strategjike.

Qasja strategjike ndaj palëve të interesuara

Në periudhën e ardhshme, ACDC do ta përshtatë në mënyrë më sistematike qasjen ndaj grupeve të ndryshme:

- përfituesit e drejtpërdrejtë do të përfshihen në mënyrë më aktive në planifikimin dhe vlerësimin e programeve;
- partnerët kryesorë do të përfshihen në zhvillimin dhe zbatimin e përbashkët të iniciativave;
- institucionet do të jenë në fokus të bashkëpunimit, avokimit dhe monitorimit;
- donatorët do të përfshihen përmes komunikimit strategjik më afatgjatë;
- mediat dhe publiku profesional do të kontribuojnë në shpërndarjen e informacioneve për aktivitetet dhe rezultatet;
- aktorët me ndikim të lartë dhe interes më të ulët do të informohen dhe përfshihen në mënyrë të synuar kur të jetë e nevojshme.

.

3.3. Analiza SWOT

Analiza SWOT ofron një vështrim të integruar të fuqive dhe dobësive të brendshme të ACDC-së, si dhe të mundësive dhe kërcënimeve nga mjedisi i jashtëm. Qëllimi është të tregojë se mbi cilat baza organizata mund ta ndërtojë zhvillimin e mëtejshëm dhe cilat rreziqe duhet t'i zvogëlojë.

Fuqitë



Fuqitë më të rëndësishme të ACDC-së janë:

- përvoja dhe njohuritë e punonjësve;
- marrëdhëniet e mira brenda ekipit;
- bashkëpunimi me institucionet;
- njohja dhe prania në komunitet;
- dukshmëria e mirë në rrjetet sociale;
- pozicionimi gjeografik në Mitrovicën Veriore;
- puna me të rinjtë dhe nxitja e pjesëmarrjes së tyre;
- përvoja në ndërlidhjen e komuniteteve;
- rrjeti i zhvilluar i partnerëve;
- përvoja në iniciativat e gjelbra;
- fleksibiliteti dhe aftësia për t'iu përshtatur ndryshimeve;
- aftësia për të ndërlidhur hulumtimet, avokimin dhe punën me qytetarët.

Vlera e veçantë e ACDC-së buron nga prania e saj lokale dhe njohja e rrethanave në veri të Kosovës, krahas lidhjeve të zhvilluara me shoqërinë civile, institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët rajonal.

Dobësitë

Dobësitë më të rëndësishme të brendshme janë:

- ndarja e pamjaftueshme dhe e paqartë e detyrave dhe përgjegjësi;
- mungesa e projekteve afatgjata dhe e financimit më të qëndrueshëm;
- diversifikimi i pamjaftueshëm i fondeve dhe donatorëve;
- mungesa e ekspertëve për fusha të caktuara të specializuara;
- kapacitetet e kufizuara për përgatitjen e projekteve më komplekse, veçanërisht të projekteve të Bashkimit Evropian;
- mospërputhja ndërmjet vëllimit të punës dhe burimeve ose kompensimit në dispozicion;
- numri tepër i madh i temave të ndryshme dhe rreziku i shpërndarjes së tepërt programore;
- bashkëpunimi jo mjaftueshëm i mirë me organizata të caktuara të shoqërisë civile;
- ngarkesa tepër e madhe administrative;
- sistemi i pazhvilluar mjaftueshëm i monitorimit, vlerësimit dhe të nxënimit organizativ;
- menaxhimi i njohurive dhe dokumentacionit, i cili nuk është sistematizuar mjaftueshëm.



Këto dobësi nuk tregojnë se ACDC duhet t'i braktisë fushat ekzistuese të punës, por se duhet t'i përcaktojë më qartë prioritetet dhe t'i forcojë sistemet e brendshme që mbështesin zbatimin e tyre.

Mundësitë

Mundësitë më të rëndësishme për zhvillim janë:

- përdorimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja;
- pjesëmarrja më e madhe e qytetarëve;
- zgjerimi i aktiviteteve të avokimit;
- zhvillimi i ideve dhe qasjeve të reja programore;
- ndërlidhja rajonale;
- kontaktet me donatorë të rinj;
- interesimi më i madh i të rinjve;
- zhvillimi profesional i ekipit;
- zhvillimi i programeve mjedisore;
- roli i ACDC-së si urë lidhëse ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror;
- zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve;
- nxitja e sipërmarrjes lokale dhe iniciativave shoqërore;
- ndërlidhja me ekspertë dhe institucione akademike.

Një mundësi e veçantë për ACDC-në qëndron në aftësinë e organizatës për t'i bartur problemet lokale nga veriu i Kosovës në hapësirën më të gjerë institucionale dhe publike, por edhe për t'i bërë informacionet dhe politikat nga niveli qendror më të kuptueshme dhe më të qasshme për qytetarët.

Kërcënimet

Kërcënimet më të rëndësishme janë:

- ndryshimet politike dhe paqëndrueshmëria;
- ndryshimet jotransparente të ligjeve dhe zbatimi i tyre selektiv;
- ndryshimet ekonomike dhe zvogëlimi i fondeve në dispozicion;
- përhapja e dezinformatave;
- fushatat negative mediatike;



- tensionet etnike;
- migrimi;
- largimi i profesionistëve dhe të rinjve;
- bashkëpunimi i ndërlikuar dhe politikisht i ndjeshëm me policinë;
- gatishmëria e zvogëluar e institucioneve për bashkëpunim;
- mbingarkesa e ekipit;
- rreziku i largimit të punonjësve;
- rritja e rreziqeve të sigurisë;
- varësia nga financimi përmes projekteve.

Përfundimet strategjike të analizës SWOT

Analiza SWOT konfirmon se ACDC zotëron përvojë të fuqishme programore, prani lokale, njohuri profesionale dhe një rrjet të zhvilluar marrëdhëniesh. Organizata ka një bazë të mirë për zhvillim të mëtejshëm dhe mund ta forcojë rolin e saj në ndërlidhjen e qytetarëve, komuniteteve, institucioneve dhe donatorëve.

Në të njëjtën kohë, faza e ardhshme e zhvillimit kërkon:

- ndarje më të qartë të detyrave;
- planifikim më realist të ngarkesës së punës;
- shfrytëzim më të madh të ekspertizës së jashtme;
- forcim të kapaciteteve për zhvillimin e projekteve të mëdha dhe afatgjata;
- diversifikim të donatorëve;
- zhvillim të një sistemi funksional MEL;
- zvogëlim të ngarkesës administrative;
- ndërlidhje më të qartë programore të fushave të ndryshme të punës;
- menaxhim më të kujdesshëm të marrëdhënieve me policinë, institucionet dhe akterët e tjerë politikisht të ndjeshëm.

Prandaj, periudha e ardhshme strategjike nuk duhet të përqendrohet kryesisht në zgjerimin e mëtejshëm të numrit të temave, por në menaxhimin më cilësor të programeve ekzistuese, forcimin e kapaciteteve të



brendshme dhe ndërlidhjen më të qëndrueshme të punës së ACDC-së me nevojat e qytetarëve dhe me ndryshimet afatgjata në të cilat organizata synon të kontribuojë.

4. IDENTITETI ORGANIZATIV

Identiteti organizativ i ACDC-së bazohet në punën e tij shumëvjeçare në Mitrovicën Veriore dhe në mjedise të tjera në Kosovë, në njohjen e nevojave të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë, si dhe në aftësinë për të bashkuar qytetarët, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile rreth çështjeve me interes publik.

Gjatë periudhave të mëparshme strategjike, ACDC ka zhvilluar programe në fushat e sundimit të ligjit, qytetarisë aktive, bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, përfshirjes sociale, punës me të rinjtë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Zgjerimi i temave dhe metodave të punës nuk e ka ndryshuar qëllimin themelor të organizatës për të kontribuar në një shoqëri në të cilën qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, të ndikojnë në vendimet që kanë të bëjnë me ta dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike.

Prandaj, strategjia e re nuk vendos një identitet të ri të organizatës, por përcakton më saktësisht qëllimin e përbashkët të programeve të ndryshme të ACDC-së. Misioni, vizioni dhe vlerat përbëjnë bazën për përzgjedhjen e prioriteteve programore, zhvillimin e partneriteteve, marrëdhëniet me qytetarët dhe institucionet, si dhe shqyrtimin e projekteve dhe burimeve të reja të financimit.

4.1. Misioni

Misioni përcakton arsyen e ekzistencës së ACDC-së, me kë dhe për kë punon, në cilat ndryshime dëshiron të kontribuojë dhe në çfarë mënyre vepron.

ACDC e bazon punën e tij kryesisht në nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve në Kosovë, me fokus të veçantë në veriun e Kosovës, komunitetin serb dhe komunitetet e tjera joshumicë. Në të njëjtën kohë, organizata bashkëpunon me institucionet e nivelit lokal dhe qendror, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë, sepse ndryshimet në fushën e qasjes në drejtësi, politikave publike dhe marrëdhënieve shoqërore nuk mund të arrihen vetëm përmes veprimit të një grupi akterësh.

Sundimi i ligjit mbetet pjesë qendrore e identitetit të ACDC-së, por nuk trajtohet i ndarë nga qytetaria aktive, dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve, përfshirja sociale dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Qasja në drejtësi dhe llogaridhënia e institucioneve lidhen me aftësinë e qytetarëve për t'i kuptuar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje. Besimi ndërmjet komuniteteve zhvillohet përmes dialogut të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve konkrete. Përfshirja sociale kërkon dukshmëri dhe pjesëmarrje të barabartë të grave, pakicave seksuale, të rinjve dhe grupeve të tjera që përballen me diskriminim ose me qasje të kufizuar në jetën publike.

ACDC i realizon këto qëllime duke ndërlidhur hulumtimet dhe analizat profesionale me avokimin publik, edukimin, dialogun dhe iniciativat praktike në komunitet.

Misioni i ACDC-së

ACDC punon me qytetarët dhe institucionet në Kosovë, me fokus të veçantë në veriun e Kosovës dhe komunitetet joshumicë, për avancimin e sundimit të ligjit, qytetarisë aktive, dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes hulumtimeve, avokimit publik, edukimit dhe iniciativave lokale.



4.2. Vizioni

Vizioni i ACDC-së përshkruan ndryshimet shoqërore në të cilat organizata dëshiron të kontribuojë në planin afatgjatë. Ai nuk paraqet pozitën e dëshiruar të vetë organizatës, por gjendjen e synuar në komunitetet dhe institucionet në Kosovë.

Në qendër të vizionit janë të drejtat e barabarta, institucionet që japin llogari para qytetarëve dhe një shoqëri në të cilën dallimet nuk përbëjnë arsye për përjashtim ose ndarje. Për ACDC-në, kultura demokratike nuk nënkupton vetëm ekzistencën e ligjeve dhe institucioneve, por edhe mundësinë reale të qytetarëve për të marrë pjesë në jetën publike, për të kërkuar llogaridhënie dhe për të bashkëpunuar me pjesëtarët e komuniteteve dhe grupeve të tjera shoqërore.

Vizioni gjithashtu pranon se stabiliteti shoqëror dhe institucional nuk mund të jetë i qëndrueshëm pa një qasje të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe burimeve lokale.

Vizioni i ACDC-së

Vizioni i ACDC-së është një shoqëri e hapur dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë, në të cilën të gjithë kanë të drejta të barabarta, institucionet japin llogari para qytetarëve, dallimet respektohen dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve bazohen në bashkëpunim, mirëkuptim dhe respekt të ndërsjellë, krahas një qasjeje të përgjegjshme ndaj mjedisit.

4.3. Vlerat organizative

Vlerat e organizatës përcaktojnë mënyrën se si ACDC e realizon misionin e tij. Ato zbatohen në marrëdhëniet brenda ekipit, në punën me qytetarët dhe komunitetet, në bashkëpunimin me institucionet dhe partnerët, në realizimin e hulumtimeve dhe në menaxhimin e burimeve financiare dhe burimeve të tjera.

Prioritetet programore dhe metodat e punës mund t'u përshtaten ndryshimeve në mjedis, por vlerat përfaqësojnë standarde të qëndrueshme, në bazë të të cilave ACDC merr vendime dhe vlerëson cilësinë e punës së tij.

Përgjegjshmëria dhe transparencia

ACDC i menaxhon me përgjegjësi burimet që i janë besuar, i arsyeton qartë vendimet e tij dhe ofron informacione të sakta për punën, financimin dhe rezultatet e organizatës. Transparencia nënkupton hapje ndaj qytetarëve, partnerëve dhe donatorëve, duke respektuar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithëpërfshirja dhe bashkëqeverisje

ACDC respekton identitetet, përvojat dhe nevojat e ndryshme dhe synon të përfshijë qytetarët që nuk janë të përfaqësuar sa duhet në jetën publike dhe institucionale. Kjo vlerë nënkupton mundësinë reale që komunitetet dhe grupet e ndryshme shoqërore të ndikojnë në aktivitete dhe të marrin pjesë në vendimmarrje, duke siguruar përfaqësim efektiv dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Bashkëpunimi dhe partneriteti



ACDC zhvillon marrëdhënie të bazuara në respekt të ndërsjellë, përgjegjësi të përbashkët dhe role të përcaktuara qartë. Organizata zhvillon partneritete me qytetarët, shoqërinë civile, institucionet dhe akterët ndërkombëtarë kur një bashkëpunim i tillë mund të kontribuojë në realizimin e të drejtave dhe zgjidhjen e problemeve konkrete.

Kompetenca dhe profesionalizmi

Puna e ACDC-së bazohet në njohuri profesionale, përgatitje cilësore, zbatim të përgjegjshëm të aktiviteteve dhe mësim të vazhdueshëm. Organizata përdor metoda dhe të dhëna të verifikuara, zhvillon kapacitetet e ekipit dhe angazhon ekspertë të jashtëm kur nuk disponon ekspertizën e duhur të brendshme për një detyrë të caktuar.

Objektiviteti dhe paanshmëria

ACDC i bazon analizat, qëndrimet dhe rekomandimet e tij në fakte, standarde ligjore dhe përvojat e qytetarëve. Organizata nuk i përshtat gjetjet sipas interesave të partive politike, institucioneve ose donatorëve.

Paanshmëria nuk nënkupton mungesën e një orientimi të bazuar në vlera. ACDC mbron në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e njeriut, barazinë, mosdiskriminimin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve.

Konfidencialiteti dhe besimi

ACDC mbron të dhënat personale, identitetin dhe sigurinë e personave që marrin pjesë në hulumtime, konsultime dhe aktivitete të tjera. Besimi i qytetarëve, punonjësve dhe partnerëve ndërtohet përmes veprimit të qëndrueshëm, respektimit të detyrimeve të marra përsipër dhe trajtimit të përgjegjshëm të informacioneve të ndjeshme.

4.4. Identiteti organizativ si kriter për vendimmarrje

Misioni, vizioni dhe vlerat nuk do të kenë vetëm funksion deklarativ. ACDC do t'i përdorë ato gjatë vlerësimit të programeve të reja, partneriteteve, mundësive të financimit nga donatorët dhe angazhimeve publike.

Gjatë shqyrtimit të iniciativave të reja, organizata do të vlerësojë nëse ato:

- u përgjigjen nevojave të qytetarëve dhe komuniteteve me të cilat punon ACDC;
- kontribuojnë në të paktën një objektiv strategjik;
- respektojnë vlerat e organizatës;
- mund të zbatohen në mënyrë profesionale dhe me kapacitetet në dispozicion;
- nuk e cenojnë pavarësinë dhe kredibilitetin e organizatës ose besimin e komuniteteve;
- prodhojnë rezultate që shkojnë përtej realizimit të aktiviteteve të projektit.

Në këtë mënyrë, identiteti organizativ bëhet një kornizë praktike për ruajtjen e fokusit programor dhe vazhdimësisë së punës së ACDC-së gjatë gjithë periudhës strategjike.



5. QËLLIMET STRATEGJIKE

Rezultatet e procesit të planifikimit strategjik treguan se ACDC, gjatë periudhës së ardhshme, nuk planifikon ndonjë ndryshim thelbësor të identitetit të tij dhe as braktisjen e fushave ekzistuese programore. Organizata ka përvojë të konsiderueshme, partneritete të zhvilluara dhe kredibilitet, të cilat përbëjnë një bazë të fuqishme për zhvillimin e mëtejshëm.

Në të njëjtën kohë, analiza vuri në dukje nevojën për një orientim më të madh strategjik, ndërlidhje më të fuqishme të fushave të ndryshme programore dhe menaxhim më sistematik të zhvillimit organizativ. Prandaj, zhvillimi i ardhshëm i ACDC-së nuk do të përqendrohet kryesisht në rritjen e numrit të temave dhe aktiviteteve, por në përmirësimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe ndikimit afatgjatë të programeve ekzistuese.

Rëndësi të veçantë do të ketë ndërlidhja më e qëndrueshme e vendimeve programore me nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve me të cilat punon ACDC, duke ruajtur njëkohësisht fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin politik, institucional dhe shoqëror. Prandaj, strategjia e re përcakton një drejtim të përbashkët zhvillimor, i cili ndërlidh programet, partneritetet, kapacitetet organizative dhe burimet.

Objektivat strategjikë janë përcaktuar në bazë të analizës së punës së deritanishme, ndryshimeve në mjedisin e jashtëm dhe nevojave të komuniteteve. Ato përbëjnë kornizën për orientimin e programeve, projekteve, partneriteteve dhe zhvillimit të brendshëm të organizatës gjatë periudhës së ardhshme strategjike.

Prandaj, ACDC do të përmirësojë strukturën organizative, ndarjen e përgjegjësi, zhvillimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e ngarkesës së punës, koordinimin e brendshëm dhe sistemet digjitale. Qëllimi nuk është krijimi i administratës shtesë, por vendosja e mekanizmave të qartë dhe të zbatueshëm që i mundësojnë ekipit punë më efikase, shkëmbim më të mirë të njohurive dhe përgjegjshmëri më të madhe për rezultatet. Planifikimi programor dhe financiar do të lidhet me zhvillimin e kapaciteteve të organizatës.

6.1. Struktura organizative dhe ndarja e përgjegjësi

ACDC do t'i përcaktojë më qartë rolet e punonjësve dhe bashkëpunëtorëve, linjat e përgjegjësisë dhe proceset vendimmarrëse. Për funksionet kryesore programore dhe organizative do të përcaktohet se kush e koordinon procesin, kush merr pjesë në zbatimin e tij dhe kush i miraton vendimet përfundimtare. Ndarja më e qartë e përgjegjësi duhet t'i zvogëlojë situatat në të cilat disa anëtarë të ekipit merren me të njëjtën detyrë pa pasur një person përgjegjës të përcaktuar qartë.

Struktura organizative do të rishqyrtohet në mënyrë periodike, në përputhje me zgjerimin e aktiviteteve, vëllimin e punës dhe burimet në dispozicion. Ndryshimet nuk do të varen vetëm nga kërkesat e projekteve të veçanta, por edhe nga funksionet afatgjata të nevojshme për zbatimin e strategjisë.

6.2. Zhvillimi i burimeve njerëzore

ACDC do ta planifikojë në mënyrë më sistematike zhvillimin e njohurive dhe shkathtësi të anëtarëve të ekipit. Ngritja profesionale do të lidhet me objektivat strategjike dhe nevojat e vendeve të punës dhe jo vetëm me trajnimet dhe mundësitë e disponueshme në kuadër të projekteve.

Fushat prioritare të zhvillimit do të përfshijnë:

- hulumtimin dhe analizën e politikave publike;
- avokimin publik dhe punën me institucionet;
- punën me komunitetet dhe metodat pjesëmarrëse;
- menaxhimin e projekteve dhe financave;
- monitorimin, vlerësimin dhe të nxëniet organizativ;
- komunikimin dhe mbledhjen e fondeve;
- mjetet digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave;
- punën me tema të ndjeshme politike dhe shoqërore.



Organizata do t'i përmirësojë edhe proceset e orientimit të punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të rinj në punë. Zhvillimi i burimeve njerëzore do të përfshijë edhe diskutime më të rregullta për performancën, ngarkesën e punës, nevojat e punonjësve dhe mundësitë për zhvillim profesional.

6.3. Menaxhimi i ngarkesës së punës dhe angazhimi i mbështetjes profesionale

Planifikimi i aktiviteteve do të lidhet me vlerësimin real të kohës, njohurive dhe burimeve të nevojshme për zbatimin e tyre. Përpara zhvillimit të projekteve të reja ose marrjes së vendimit për aplikim, ACDC do të vlerësojë nëse mund të sigurohen kapacitetet e nevojshme njerëzore, profesionale dhe organizative për zbatimin cilësor të tyre.

Organizata nuk do të niset nga supozimi se të gjitha detyrat duhet t'i kryejë ekipi ekzistues. Për analiza juridike dhe analiza të tjera profesionale, vlerësime, dizajn, zgjidhje teknike, hulumtime dhe punë të tjera të specializuara do të angazhohen ekspertë të jashtëm kur kapacitetet përkatëse nuk janë të disponueshme brenda organizatës.

Një qasje e tillë duhet të zvogëlojë mbingarkesën e punonjësve dhe t'u mundësojë anëtarëve të ekipit të përqendrohen në funksionet ku mund të japin kontributin më të madh.

6.4. Menaxhimi i njohurive dhe koordinimi i brendshëm

ACDC do të zhvillojë një sistem në të cilin dokumentacioni, të dhënat, kontaktet, metodologjitë dhe përvojat nga projektet përbëjnë burim të përbashkët të organizatës.

Do të përmirësohen mënyrat e ruajtjes dhe organizimit të dokumentacionit, evidentimit të vendimeve dhe shkëmbimit të informacioneve. Pas programeve dhe aktiviteteve më të rëndësishme do të evidentohen mësimet e nxjerra, qasjet e suksesshme dhe problemet që duhet të shmangen në punën e ardhshme.

Takimet e rregullta të ekipit do të shërbejnë për koordinimin e aktiviteteve, si dhe për:

- shkëmbimin e njohurive dhe vlerësimeve programore;
- monitorimin e nevojave të komuniteteve;
- ndërldhjen e projekteve të ndryshme me objektivat strategjike;
- shqyrtimin e rreziqeve dhe ngarkesës së punës;
- të nxënit e përbashkët dhe përshtatjen e qasjeve.

6.5. Kapacitetet digjitale dhe teknike

Mjetet digjitale do të përdoren për planifikim më efikas, menaxhim të projekteve, bashkëpunim të ekipit, mbledhje dhe analizë të të dhënave, si dhe komunikim me qytetarët dhe partnerët.

ACDC do t'i përmirësojë rregullat për:

- ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit elektronik;
- menaxhimin e qasjes në sistemet digjitale;
- mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave të hulumtimeve;
- përdorimin e sigurt të platformave në internet;



- krijimin e kopjeve rezervë dhe ruajtjen e kujtesës institucionale.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së të dhënave të mbledhura përmes hulumtimeve dhe punës me pjesëtarët e grupeve të ndjeshme në aspektin politik, shoqëror ose të sigurisë.

Inteligjenca artificiale dhe mjetet e tjera të reja mund të kontribuojnë në efikasitetin e hulumtimeve, administrimit dhe komunikimit, por zbatimi i tyre duhet të përfshijë verifikimin njerëzor, mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësisë për rezultatet përfundimtare.

6.6. Rezultati i pritshëm zhvillimor

Deri në fund të periudhës strategjike, ACDC do të ketë një strukturë organizative më funksionale, përgjegjësi të ndara më qartë dhe burime njerëzore të harmonizuara më mirë me prioritetet programore.

Ngarkesa e punës do të planifikohet në mënyrë më realiste, ndërsa mbështetja e jashtme profesionale do të përdoret kur ekipi ekzistues nuk i ka kapacitetet e nevojshme. Proceset kryesore do të varen më pak nga individët, ndërsa dokumentacioni, njohuritë dhe mësimet e nxjerra do të ruhen në mënyrë më sistematike dhe do të jenë të qasshme për anëtarët e ekipit.

Sistemet digjitale dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave do të mundësojnë punë më efikase dhe më të sigurt, ndërsa zhvillimi organizativ do të lidhet në mënyrë më të drejtpërdrejtë me zbatimin e objektivave strategjikë.

7. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE TË MËSUARIT ORGANIZATIV (MEL)

ACDC do të zhvillojë një sistem të monitorimit, vlerësimit dhe të nxënit organizativ, i cili mundëson monitorimin e rezultateve në nivelin e të gjithë strategjisë dhe jo vetëm në kuadër të projekteve të veçanta.

Monitorimi i mëparshëm i punës është formësuar në masë të madhe nga kërkesat e donatorëve dhe treguesit e projekteve. Një qasje e tillë mundëson raportim të rregullt për aktivitetet e realizuara, numrin e pjesëmarrësve, publikimet e hartuara dhe rezultatet e drejtpërdrejta, por jo gjithmonë tregon mjaftueshëm qartë se në çfarë ndryshimesh ka kontribuar ACDC në komunitete, në punën e institucioneve dhe në politikat publike.

Gjatë periudhës së ardhshme, sistemi MEL do t'i ndërlidhë të pesë objektivat strategjikë dhe do të mundësojë që rezultatet e projekteve të ndryshme të trajtohen si pjesë e performancës më të gjerë programore të organizatës. Qëllimi i tij nuk do të jetë krijimi i administratës shtesë, por identifikimi në kohë të qasjeve të suksesshme, dobësive, pasojave të paqëllimshme dhe nevojave për përshtatjen e programeve.

ACDC do të bëjë dallimin ndërmjet rezultateve të drejtpërdrejta të punës së tij dhe ndikimit më të gjerë shoqëror dhe institucional në të cilin kontribuon. Organizata mund të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për cilësinë e hulumtimeve, trajnimeve, dialogëve, iniciativave lokale dhe rekomandimeve, por ndryshimet në punën e institucioneve, politikat publike ose marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve varen edhe nga faktorë të shumtë të jashtëm. Për këtë arsye, kontributi i ACDC-së do të vlerësohet në bazë të dëshmive në dispozicion.

7.1. Korniza për monitorimin e strategjisë

Për çdo objektiv strategjik dhe specifik do të përcaktohen:



- rezultatet e pritshme;
- një numër i kufizuar treguesish;
- vlerat fillestare, kur ato janë të disponueshme;
- vlerat e synuara ose drejtimi i pritshëm i ndryshimit;
- burimet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave;
- shpeshtësia e monitorimit;
- përgjegjësitë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Treguesit do të jenë mjaftueshëm konkretë për të mundësuar monitorimin e progresit, por numri i tyre nuk do të jetë më i madh sesa organizata mund të monitorojë në mënyrë të besueshme dhe të rregullt.

Planet vjetore të veprimit do të përmbajnë tregues më të drejtpërdrejtë të aktiviteteve dhe rezultateve, ndërsa korniza strategjike MEL do të përqendrohet në ndryshimet më të gjera programore dhe organizative.

7.2. Monitorimi i rezultateve dhe kontributit në ndryshime

ACDC do t'i ruajë të dhënat bazë për numrin e aktiviteteve, pjesëmarrësve, publikimeve dhe raportimeve mediatike, por ato nuk do të përbëjnë dëshmi të mjaftueshme të suksesit.

Rëndësi më të madhe do të kenë të dhënat që tregojnë:

- nëse qytetarët i kanë përdorur njohuritë e fituara ose kanë ndërmarrë iniciativë;
- nëse institucionet u janë përgjigjur rekomandimeve dhe kërkesave;
- nëse rekomandimet kanë ndikuar në procedura, praktika ose politika publike;
- nëse kanalet e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve kanë vazhduar të funksionojnë;
- nëse bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve ka vazhduar pas përfundimit të aktiviteteve;
- nëse grupet e përfaqësuar në mënyrë të pamjaftueshme kanë pasur rol të mirëfilltë në planifikim dhe vendimmarrje;
- nëse iniciativat lokale kanë sjellë ndryshim të dukshëm;
- nëse hulumtimet dhe analizat janë përdorur në dialogun publik, profesional ose institucional.

Kur një rezultat nuk mund të paraqitet në mënyrë të besueshme përmes një numri, do të përdoren të dhëna cilësore, studime të rasteve dhe shembuj të dokumentuar të kontributit në ndryshime.

7.3. Metodatat dhe burimet e të dhënave

Të dhënat do të mblidhen duke kombinuar burime dhe metoda të ndryshme, duke përfshirë:

- evidencat e projekteve dhe programeve;
- anketat para dhe pas aktiviteteve;



- intervistat dhe grupet e fokusit;
- komentet dhe vlerësimet e pjesëmarrësve dhe partnerëve;
- konsultimet me qytetarët dhe grupet e synuara;
- monitorimin e përgjigjeve të institucioneve;
- analizën e dokumenteve publike, vendimeve dhe politikave;
- monitorimin e mediave dhe diskursit publik;
- vlerësimet periodike të partneriteteve dhe iniciativave lokale.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet përvojave të qytetarëve nga veriu i Kosovës, pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë, si dhe grupeve që janë më pak të përfaqësuara në punën e organizatave të shoqërisë civile.

ACDC nuk do t'i vlerësojë nevojat e komuniteteve vetëm në bazë të qëndrimeve të partnerëve të përhershëm, pjesëmarrësve në projekte ose komunitetit profesional. Kur të jetë e mundur, konsultimet do të përfshijnë edhe qytetarët që nuk kanë përvojë të mëparshme në programet e ACDC-së.

7.4. Zbërthimi dhe mbrojtja e të dhënave

Kur të jetë relevante, vullnetare dhe e sigurt, të dhënat do të zbërthehen sipas gjinisë, moshës, nivelit të arsimit, vendbanimit, përkatësisë etnike dhe karakteristikave të tjera të nevojshme për vlerësimin e qasjes së barabartë në programe.

Zbërthimi i të dhënave do ta ndihmojë ACDC-në të përcaktojë nëse programet arrijnë vërtet deri te grupet e synuara apo mbështeten në një numër të vogël pjesëmarrësish tashmë aktivë dhe të qasshëm.

Në të njëjtën kohë, të dhënat për përkatësinë etnike, orientimin seksual, qëndrimet politike, sigurinë dhe përvojat me institucionet mund të paraqesin rreziqe për pjesëmarrësit. Prandaj, ACDC do të zbatojë parimin e mbledhjes minimale të të dhënave, pëlqimin e informuar, ruajtjen e sigurt të dokumentacionit dhe qasjen e kufizuar në informacione të ndjeshme.

Paraqitja publike e rezultateve nuk do të mundësojë identifikimin e pjesëmarrësve kur kjo mund të rrezikojë privatësinë, sigurinë ose pozitën e tyre në komunitet.

7.5. Vlerësimi i programeve dhe strategjisë

Krahas monitorimit të rregullt, ACDC do të realizojë vlerësime të programeve dhe partneriteteve më të rëndësishme kur nevojitet një vlerësim më i thelluar i relevancës, cilësisë, efikasitetit, qëndrueshmërisë ose kontributit të tyre në ndryshime.

Vlerësimet mund të jenë të brendshme ose t'u besohen ekspertëve të jashtëm. Vlerësimi i jashtëm do të ketë përparësi kur kërkohet një vlerësim i pavarur, ekspertizë e specializuar ose kur programi përfshin tema të ndjeshme politike dhe shoqërore. Në mesin e periudhës strategjike do të realizohet një rishikim i zbatimit të strategjisë, ndërsa në fund të periudhës do të kryhet vlerësimi përfundimtar.

7.6. Mësimi organizativ



Mbledhja e të dhënave ka vlerë vetëm nëse gjetjet përdoren për përmirësimin e punës. Prandaj, ACDC do të krijojë procese të rregullta përmes të cilave ekipi do të shqyrtojë rezultatet e arritura, qasjet e suksesshme dhe të pasuksesshme, ndryshimet në nevojat e komuniteteve dhe nevojën për përshtatjen e programeve.

Mësimi organizativ do të përfshijë:

- dokumentimin e qasjeve të suksesshme dhe të pasuksesshme;
- shkëmbimin e përvojave ndërmjet anëtarëve të ekipit;
- përdorimin e gjetjeve për zhvillimin e projekteve të reja;
- përshtatjen e metodologjive të punës;
- rishqyrtimin e aktiviteteve që nuk japin rezultatet e pritshme;
- identifikimin e nevojave dhe rreziqeve të reja;
- shkëmbimin e njohurive përkatëse me partnerët dhe komunitetet.

ACDC do të nxisë një kulturë në të cilën devijimi nga plani ose dështimi i një aktiviteti të caktuar nuk duhet të fshihet, por të analizohet për ta përmirësuar punën e ardhshme. Përshtatja e programeve do të bazohet në të dhëna dhe përvoja të dokumentuara dhe jo vetëm në përshtypje individuale.

7.7. Përgjegjësitë për MEL-in

Përgjegjësia për MEL-in nuk do të kufizohet te një person dhe as në fazën përfundimtare të raportimit. Ekipet programore do të jenë përgjegjëse për cilësinë dhe dorëzimin në kohë të të dhënave nga fushat e tyre, ndërsa koordinatori për monitorim, vlerësim dhe të nxënit (MEL) do t'i bashkojë të dhënat dhe do të përgatisë pasqyra periodike të zbatimit të strategjisë.

Udhëheqja e ACDC-së do t'i përdorë gjetjet e sistemit MEL gjatë:

- përcaktimit të prioritetëve vjetore;
- vlerësimit të mundësive të reja për projekte;
- shpërndarjes së burimeve njerëzore dhe financiare;
- vendimmarrjes për vazhdimin, përshtatjen ose përfundimin e programeve;
- paraqitjes së rezultateve para komuniteteve, partnerëve dhe donatorëve.

7.8. Rezultati i pritshëm zhvillimor

Deri në fund të periudhës strategjike, ACDC do të ketë një sistem funksional dhe të zbatueshëm MEL, i cili i ndërlidh rezultatet e projekteve me objektivat strategjike të organizatës.

Organizata do të disponojë të dhëna më të besueshme për personat që marrin pjesë në programet e saj, ndryshimet që ndodhin, mënyrën se si institucionet u përgjigjen iniciativave dhe qasjet që sjellin rezultate më të qëndrueshme.

Gjetjet do të përdoren rregullisht për planifikimin programor, menaxhimin e burimeve dhe përshtatjen e punës ndaj ndryshimeve në Kosovë dhe në komunitetet me të cilat bashkëpunon ACDC. Suksesi i



organizatës do të paraqitet më qartë përmes ndryshimeve të dokumentuara, përgjigjeve institucionale, përvojave të qytetarëve dhe mësimave të nxjerra dhe jo vetëm përmes numrit të aktiviteteve të realizuara.

8. KOMUNIKIMI DHE DUKSHMËRIA STRATEGJIKE

Komunikimi do të lidhet drejtpërdrejt me objektivat strategjike të ACDC-së dhe do të përdoret për të mbështetur hulumtimet, avokimin publik, punën me komunitetet dhe marrëdhëniet me institucionet.

ACDC do ta bazojë komunikimin në një masë më të vogël në prezantimin e aktiviteteve të veçanta të projekteve dhe më shumë në shpjegimin e qartë të problemeve me të cilat merret, gjetjeve të arritura, qëndrimeve që përfaqëson dhe ndryshimeve në të cilat kontribuon. Në këtë mënyrë, organizata do ta forcojë njohjen e saj si një aktor relevant dhe i besueshëm në fushat e sundimit të ligjit, qytetarisë aktive, bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet komunikimit me qytetarët në veri të Kosovës, komunitetin serb dhe komunitetet e tjera joshumicë, institucionet, mediat, partnerët dhe donatorët. Përmbajtjet do t'u përshtaten grupeve të ndryshme të synuara dhe do të shpërndahen përmes kanaleve që këto grupe i përdorin realisht.

Komunikimi nuk do të shërbejë vetëm për promovimin përfundimtar të aktiviteteve të realizuara, por do të planifikohet që nga fillimi i programeve, së bashku me objektivat, grupet e synuara dhe rezultatet e pritshme.

8.1. Qasja strategjike ndaj komunikimit

Aktivitetet e komunikimit do të ndërlidhen me prioritetet programore dhe rezultatet e pritshme të strategjisë. Gjatë planifikimit të komunikimit, ACDC do të përcaktojë:

- kujt i dedikohet mesazhi;
- cili problem, gjetje ose rekomandim komunikohet;
- cilin reagim ose ndryshim duhet të nxisë komunikimi;
- cili kanal dhe format i përshtatet më së miri grupit të synuar;
- si do të vlerësohen shtrirja dhe efekti i komunikimit.

Një qasje e tillë duhet të mundësojë që komunikimi të jetë pjesë përbërëse e avokimit publik, informimit të qytetarëve, mobilizimit të komuniteteve dhe marrëdhënieve me institucionet.

8.2. Komunikimi i rezultateve programore

ACDC do të paraqesë në mënyrë më të qartë dhe më sistematike:

- gjetjet e hulumtimeve dhe analizave profesionale;
- rekomandimet për institucionet dhe politikat publike;
- përvojat dhe nevojat e qytetarëve;
- rezultatet e iniciativave lokale dhe rinore;
- përgjigjet e institucioneve ndaj propozimeve avokuese;



- shembujt e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve;
- ndryshimet në të cilat ka kontribuar organizata.

Përmbajtjet e ndërlikuara juridike, politike dhe institucionale do të paraqiten edhe në formate më të shkurtra dhe më të qasshme, në mënyrë që të jenë të kuptueshme për qytetarët që nuk janë pjesë e komunitetit profesional.

Krahas publikimit të rezultateve, ACDC do të monitorojë edhe përdorimin e tyre, përkatësisht nëse ato janë transmetuar nga mediat, janë shqyrtuar nga institucionet, janë përdorur nga organizatat partnere ose janë njohur nga grupet e synuara.

8.3. Grupet e synuara, gjuhët dhe kanalet

Qasja e komunikimit do t'u përshtatet audiencave të ndryshme. Qytetarëve do t'u ofrohen informacione të qarta dhe praktike, institucioneve rekomandime të përmbledhura dhe dëshmi, mediave gjetje në kohë dhe të verifikueshme, ndërsa partnerëve dhe donatorëve do t'u paraqiten rezultatet më të gjera programore dhe ndryshimet në komunitet.

ACDC do të përdorë kanale të ndryshme komunikimi, duke përfshirë:

- ueb-faqen dhe rrjetet sociale;
- publikimet, përmbledhjet dhe përmbajtjet vizuale;
- paraqitjet në media dhe njoftimet për media;
- konsultimet e drejtpërdrejta dhe ngjarjet në komunitete;
- rrjetet e partnerëve dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me qytetarët dhe grupet e synuara.

Kanalet e komunikimit do të përzgjidhen në përputhje me shprehitë, gjuhën dhe mundësitë e qasjes së grupeve të veçanta të synuara dhe jo vetëm sipas popullaritetit ose shtrirjes së tyre të përgjithshme.

Në përputhje me temën dhe audiencën, përmbajtjet do të jenë të disponueshme në gjuhën serbe, shqipe dhe angleze. Qasja gjuhësore duhet të mundësojë qasje të barabartë në informacione.

8.4. Identiteti i komunikimit dhe koordinimi i brendshëm

ACDC do ta përmirësojë konsistencën e përmbajtjeve që publikohen në ueb-faqe, rrjete sociale, publikime dhe paraqitje publike. Fushat programore, mesazhet kryesore dhe rezultatet do të paraqiten në mënyrë që publiku ta kuptojë më lehtë se me çfarë merret organizata dhe kujt i dedikohet puna e saj.

Ekipet e projekteve dhe koordinatori i komunikimit do të bashkëpunojnë që nga fillimi i zhvillimit të aktiviteteve. Në këtë mënyrë do të sigurohet që komunikimi të bazohet në të dhëna të besueshme, të jetë në përputhje me objektivat programore dhe të përgatitet në kohë.

Koordinimi i brendshëm duhet ta parandalojë komunikimin e shkëputur të projekteve të veçanta dhe të mundësojë që përmbajtjet e ndryshme të ndërtojnë së bashku një identitet të qartë të organizatës.

8.5. Komunikimi i përgjegjshëm

Puna me tema të ndjeshme politike, të sigurisë dhe shoqërore kërkon komunikim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm. ACDC do të kujdeset për:



- saktësinë dhe verifikueshmërinë e informacioneve;
- dallimin e qartë ndërmjet fakteve, vlerësimeve analitike dhe qëndrimeve të organizatës;
- mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale;
- sigurinë e pjesëmarrësve dhe partnerëve;
- shmangien e gjuhës diskriminuese dhe stigmatizuese;
- pasojat e mundshme të ekspozimit publik të individëve dhe grupeve.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet komunikimit për marrëdhëniet ndëretnike, policinë dhe sigurinë, mosmarrëveshjet institucionale, të drejtat e pakicave seksuale dhe tema të tjera që mund të shkaktojnë presione politike, fushata negative ose të rrezikojnë pjesëmarrësit.

Shpejtësia e publikimit nuk do të ketë përparësi ndaj saktësisë, sigurisë dhe parimeve etike.

8.6. Rezultati i pritshëm zhvillimor

Deri në fund të periudhës strategjike, komuniteti do ta njohë më qartë identitetin programor të ACDC-së, ndërsa qytetarët dhe komunitetet me të cilat punon organizata do të kenë qasje më të mirë në informacione, analiza dhe mundësi përkatëse për përfshirje.

Rezultatet e punës do të paraqiten në mënyrë më sistematike dhe do t'u përshtaten grupeve të ndryshme të synuara. Komunikimi do të kontribuojë në një masë më të madhe në dialogun publik, avokimin, ndryshimet institucionale dhe përfshirjen e qytetarëve, në vend që të kufizohet në evidentimin e aktiviteteve të realizuara.

Objektivat e hollësishëm të komunikimit, audiencat e synuara, mesazhet kryesore, kanalet, përgjegjësitë dhe treguesit do të përpunohen në Strategjinë e veçantë të Komunikimit të ACDC-së, si dokument shoqërues i kësaj strategjie.

9. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE DHE MOBILIZIMI I BURIMEVE

Qëndrueshmëria e ACDC-së varet nga aftësia e organizatës për t'i orientuar burimet njerëzore, financiare, profesionale dhe teknike drejt prioriteteve strategjike dhe për të siguruar burime të larmishme, të parashikueshme dhe të qëndrueshme financimi.

Gjatë periudhës së ardhshme, ACDC do të synojë ta zvogëlojë varësinë e vendimeve programore nga thirrjet e veçanta të donatorëve. Organizata fillimisht do t'i përcaktojë problemet me të cilat dëshiron të merret dhe ndryshimet në të cilat dëshiron të kontribuojë dhe më pas do të kërkojë donatorë, prioritetet e të cilëve janë në përputhje me misionin dhe objektivat e saj strategjikë. Një qasje e tillë nuk do ta përjashtojë fleksibilitetin.

Ndryshimet politike, institucionale dhe të sigurisë në Kosovë, veçanërisht në veri të Kosovës, mund të kërkojnë përshtatjen e programeve dhe reagimin ndaj nevojave të reja të komuniteteve. Megjithatë, çdo mundësi e re për projekt do të vlerësohet sipas rëndësisë së saj strategjike, kërkesave që i parashtron ekipit dhe mundësisë për të sjellë një rezultat që shkon përtej kohëzgjatjes së një projekti të veçantë.

9.1. Menaxhimi i burimeve



ACDC do ta ndërlidhë planifikimin e burimeve me prioritetet vjetore programore, detyrimet ekzistuese të projekteve dhe kapacitetet reale të ekipit.

Gjatë planifikimit të aktiviteteve të reja, organizata do të marrë parasysh:

- kohën dhe ngarkesën e punonjësve;
- mbështetjen e nevojshme të jashtme profesionale;
- shpenzimet programore, administrative dhe financiare;
- shpenzimet e komunikimit, monitorimit, përkthimit dhe mbrojtjes së të dhënave;
- burimet teknike dhe digjitale;
- rreziqet e sigurisë dhe reputacionit.

Iniciativat e reja për projekte do të shqyrtohen në raport me kapacitetet ekzistuese të ekipit, por edhe me mundësinë që përmes buxhetit të sigurohen punonjës, bashkëpunëtorë dhe ekspertë shtesë, të nevojshëm për zbatimin cilësor të tyre.

ACDC do të synojë që shpenzimet e funksioneve themelore organizative, duke përfshirë menaxhimin, financat, komunikimin, MEL-in, zhvillimin e programeve dhe sistemet digjitale, t'i përfshijë në masën e duhur në buxhetet e projekteve.

9.2. Mbledhja e fondeve e bazuar në prioritetet strategjike

Mbledhja e fondeve do të lidhet me pesë objektivat strategjike të ACDC-së. Organizata do t'i zhvillojë idetë e projekteve mbi bazën e nevojave të dokumentuara të qytetarëve dhe komuniteteve, përvojës së mëparshme dhe ndryshimeve të synuara shoqërore dhe institucionale.

Për fushat prioritare programore, ACDC do të zhvillojë koncepte themelore programore, të cilat mund t'u përshtaten interesave të ndryshme të donatorëve pa u larguar nga qëllimi i tyre thelbësor.

Prioritetet e donatorëve do të monitorohen rregullisht dhe do të shqyrtohen në raport me objektivat strategjike të ACDC-së, nevojat e grupeve të synuara dhe mundësitë për zhvillimin e programeve dhe kapaciteteve të organizatës. Përparësi do të kenë mundësitë që lidhen qartë me misionin dhe orientimin strategjik të ACDC-së dhe për zbatimin cilësor të të cilave mund të sigurohen kapacitetet e përshtatshme njerëzore, profesionale dhe organizative.

9.3. Diversifikimi i burimeve të financimit

ACDC do të synojë kombinimin e burimeve të ndryshme të mbështetjes, duke përfshirë:

- donatorët bilateral dhe multilateral;
- fondet e Bashkimit Evropian;
- fondacionet ndërkombëtare;
- grantet institucionale dhe shumëvjeçare;
- partneritetet me organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
- zbatimin e përbashkët të projekteve dhe nënkontraktimin.



Organizata do të synojë ta zvogëlojë varësinë nga një donator, një fushë programore ose një model financimi. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet burimeve që mundësojnë planifikim shumëvjeçar, zhvillim të kapaciteteve organizative dhe mbulim të shpenzimeve operative.

9.4. Kriteret për vlerësimin e mundësive të reja për projekte

Përpara marrjes së vendimit për zhvillimin e një ideje projekti, përgatitjen e aplikimit ose përfshirjen në një propozim partneriteti, ACDC do të vlerësojë:

- përputhshmërinë me misionin dhe objektivat strategjikë;
- ekzistencën e një nevoje të përcaktuar qartë në komunitet;
- rëndësinë për grupet e synuara dhe mjediset në të cilat vepron ACDC;
- ndryshimin e pritshëm shoqëror ose institucional;
- kapacitetet njerëzore dhe profesionale në dispozicion;
- realizueshmërinë e afateve dhe buxhetit;
- mbulimin e shpenzimeve programore dhe organizative;
- përputhshmërinë me vlerat e ACDC-së;
- rreziqet politike, të sigurisë, etike dhe të reputacionit;
- mundësinë e përdorimit dhe qëndrueshmërisë së rezultateve pas përfundimit të financimit.

Si veçanërisht të rëndësishme do të konsiderohen mundësitë për projekte që janë në përputhje me drejtimit strategjike të ACDC-së, kontribuojnë në zhvillimin e programeve dhe kapaciteteve të organizatës dhe mundësojnë sigurimin e burimeve të nevojshme për zbatimin cilësor të tyre.

9.5. Marrëdhëniet me donatorët dhe partnerët

ACDC do të zhvillojë marrëdhënie më afatgjata me donatorët, të bazuara në komunikim të rregullt, raportim cilësor dhe paraqitje të qartë të nevojave të komuniteteve, rezultateve programore dhe ndryshimeve në komunitet.

Donatorëve do t'u paraqiten veçoritë e punës në veri të Kosovës dhe në komunitetin serb dhe komunitetet e tjera joshumicë, duke përfshirë rrethanat politike, institucionale, gjuhësore dhe të sigurisë që mund të ndikojnë në zbatimin e programeve.

Partneritetet me organizata të tjera do të zhvillohen kur ato sjellin ekspertizë plotësuese, qasje të grupet e synuara, lidhje rajonale ose potencial më të madh për ndikim avokues dhe programor. Përgjegjësitë, burimet dhe kontributi i pritshëm i partnerëve do të përcaktohen qartë.

ACDC nuk do të hyjë në partneritete vetëm për përmbushjen e kërkesave formale të thirrjeve të donatorëve.

9.6. Përgjegjësitë dhe monitorimi i qëndrueshmërisë financiare

Udhëheqja e ACDC-së do të jetë përgjegjëse për orientimin strategjik të mobilizimit të burimeve dhe vendimet përfundimtare për zhvillimin e propozimeve të projekteve, aplikimin dhe hyrjen në partneritete.



Ekipet programore do të marrin pjesë në identifikimin e nevojave, zhvillimin e koncepteve programore dhe përcaktimin e rezultateve të pritshme. Funkzioni financiar dhe administrativ do të vlerësojë arsyeshmërinë e buxhetit, shpenzimet e lejuara, detyrimet financiare dhe rreziqet.

Për aplikimet më të mëdha për projekte do të përcaktohet qartë se kush e udhëheq procesin, kush e përgatit përmbajtjen programore, kush e harton buxhetin, kush e kontrollon përputhshmërinë me kushtet e thirrjes për projekte dhe kush e miraton versionin përfundimtar.

Qëndrueshmëria financiare do të monitorohet përmes një numri të kufizuar treguesish, duke përfshirë:

- numrin dhe shumëllojshmërinë e donatorëve aktivë;
- pjesën e donatorit më të madh në buxhetin e përgjithshëm;
- pjesën e financimit shumëvjeçar dhe më fleksibël;
- mbulimin e funksioneve themelore organizative;
- raportin ndërmjet detyrimeve të kontraktuara dhe kapaciteteve në dispozicion të ekipit;
- përqindjen e projekteve të reja të lidhura me objektivat strategjike;
- parashikueshmërinë financiare për gjashtë dhe dymbëdhjetë muajt e ardhshëm.

9.7. Rezultati i pritshëm zhvillimor

Deri në fund të periudhës strategjike, ACDC do të ketë një qasje më sistematike dhe më proaktive ndaj mobilizimit të burimeve, një strukturë më të larmishme financimi dhe një lidhje më të qartë ndërmjet prioritetve programore, vendimeve për projektet dhe planifikimit buxhetor.

Organizata do t'i planifikojë në mënyrë më realiste kapacitetet njerëzore dhe financiare, do ta zvogëlojë varësinë nga donatorët individualë dhe do ta rrisë aftësinë për të financuar funksionet themelore organizative dhe programet më afatgjata.

Projektet e reja do të zhvillohen në bazë të misionit, objektivave strategjike dhe nevojave të dokumentuara të komuniteteve, ndërsa gjatë vendimmarrjes për kushtet e financimit dhe aplikimin do të vlerësohet ndikimi i tyre i mundshëm në cilësinë e punës dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ACDC-së

10. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RISHIKIMI PERIODIK I STRATEGJISË

Strategjia do të përbëjë kornizën themelore për vendimmarrjen programore dhe organizative të ACDC-së gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj. Objektivat e saj do të ndërlidhen me planifikimin vjetor, zhvillimin e projekteve dhe partneriteteve, shpërndarjen e burimeve dhe vlerësimin e rezultateve të punës së organizatës.

ACDC do ta zbatojë strategjinë përmes planeve vjetore të veprimit, aktiviteteve programore dhe të projekteve, proceseve të zhvillimit organizativ dhe bashkëpunimit me qytetarët, institucionet, shoqërinë civile, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë. Projektet e reja dhe iniciativat më të rëndësishme duhet të lidhen qartë me të paktën një objektiv strategjik dhe një objektiv specifik.

Zbatimi do të jetë mjaftueshëm fleksibël për t'i mundësuar organizatës t'u përgjigjet ndryshimeve politike, institucionale dhe të sigurisë në Kosovë, veçanërisht në veri të Kosovës. Fleksibiliteti do t'i referohet përzgjedhjes së metodave, partnerëve, aktiviteteve dhe afateve, por nuk do të nënkuptojë



ndryshimin e vazhdueshëm të prioriteteve programore në përputhje me thirrjet e disponueshme të donatorëve.

10.1. Planifikimi operativ vjetor

Në fillim të çdo viti, ACDC do të përgatisë një plan veprimi, përmes të cilit objektivat strategjike dhe specifike, si dhe detyrat strategjike, do të shndërrohen në rezultate prioritare vjetore, aktivitete, afate, përgjegjësi, burime të nevojshme dhe tregues të progresit.

Plani vjetor i veprimit do ta përfshijë punën e organizatës në tërësi dhe jo vetëm detyrimet që rrjedhin nga projektet e veçanta. Aktivitetet e financuara nga burime të ndryshme do të ndërlidhen me objektivat e përbashkët programorë dhe rezultatet e pritshme, në mënyrë që kontributi i përgjithshëm i ACDC-së të vlerësohet më qartë.

Gjatë planifikimit vjetor do të shqyrtohen:

- nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve;
- ndryshimet në mjedisin politik, institucional dhe shoqëror;
- rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga viti i mëparshëm;
- detyrimet ekzistuese të projekteve dhe partneriteteve;
- kapacitetet njerëzore dhe financiare në dispozicion;
- mundësitë për bashkëpunim dhe mobilizimin e burimeve shtesë;
- rreziqet kryesore programore, të sigurisë dhe organizative.

Në bazë të planit vjetor të veprimit do të përgatitet buxheti vjetor, i cili do t'i paraqesë mjetet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe do të shërbejë si bazë për mbledhjen e fondeve.

10.2. Përgjegjësitë për zbatimin

Udhëheqja e ACDC-së do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të strategjisë, miratimin e prioriteteve vjetore dhe marrjen e vendimeve për ndryshimet më të rëndësishme programore, financiare dhe organizative.

Për çdo objektiv strategjik do të caktohet një person përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e progresit. Kjo nuk do të nënkuptojë se një person i vetëm i zbaton në mënyrë të pavarur të gjitha masat, por se ekziston një përgjegjësi e përcaktuar qartë për ndërlidhjen e aktiviteteve, rezultateve dhe të dhënave në nivelin e objektivit.

Në planin vjetor të veprimit do të përcaktohen:

- personi përgjegjës për aktivitetet e veçanta;
- anëtarët e ekipit të përfshirë në zbatim;
- personat përgjegjës për miratimin e vendimeve kryesore;
- organizatat partnere dhe institucionet;
- ekspertët e jashtëm, kur angazhimi i tyre është i nevojshëm.



Progresi do të shqyrtohet të paktën një herë në tre muaj, në kuadër të takimeve të rregullta të udhëheqjes dhe ekipit programor. Shqyrtimet do të përfshijnë rezultatet e arritura, vonesat, rreziqet, ngarkesën e punës dhe nevojën për përshtatjen e planeve ose burimeve.

10.3. Përzgjedhja e prioriteteve programore dhe të projekteve

ACDC nuk do të ketë mundësi t'i zbatojë të gjitha detyrat strategjike me të njëjtin intensitet gjatë çdo viti. Prioritetet vjetore do të përcaktohen sipas rëndësisë së problemit për grupet e synuara, mundësisë së organizatës për të dhënë kontribut konkret dhe disponueshmërisë së kapaciteteve, burimeve dhe partneriteteve të nevojshme.

Mundësitë e reja për projekte do të vlerësohen sipas:

- lidhjes me misionin dhe objektivat strategjikë;
- ekzistencës së një nevoje të dokumentuar në komunitet;
- rëndësisë për grupet e synuara dhe mjediset në të cilat punon ACDC;
- ndryshimit të pritshëm shoqëror, institucional ose organizativ;
- kapaciteteve reale dhe ngarkesës së ekipit;
- përshtatshmërisë së afateve dhe buxhetit;
- mundësisë për monitorimin e rezultateve dhe qëndrueshmërisë së tyre;
- rreziqeve politike, të sigurisë, etike dhe të reputacionit.

Mundësitë për projekte do të vlerësohen sipas përputhshmërisë së tyre me misionin dhe prioritetet strategjike të ACDC-së, nevojave të grupeve të synuara, kontributit të mundshëm në ndryshime dhe mundësisë për të siguruar kapacitetet e përshtatshme për zbatimin cilësor të tyre dhe jo vetëm sipas disponueshmërisë së financimit.

10.4. Partneritetet në zbatimin e strategjisë

ACDC do ta zbatojë strategjinë në bashkëpunim me qytetarët, organizatat lokale të shoqërisë civile, institucionet, ekspertët, mediat, grupet joformale, institucionet arsimore dhe kulturore dhe partnerët ndërkombëtarë.

Partneritetet do të bazohen në vizion dhe vlera të përbashkëta, kapacitete plotësuese, ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe kontribut në realizimin e objektivave strategjikë. Organizatat dhe komunitetet lokale nuk do të trajtohen vetëm si përfitues ose partnerë formalë, por si akterë që marrin pjesë në përcaktimin e problemeve, zhvillimin e zgjidhjeve dhe vlerësimin e rezultateve.

Bashkëpunimi me institucionet, duke përfshirë policinë, gjyqësorin dhe komunat, do të orientohet drejt ndryshimeve konkrete, duke ruajtur pavarësinë e ACDC-së dhe aftësinë e tij për ta monitoruar dhe komentuar publikisht punën e tyre në mënyrë kritike.

10.5. Monitorimi i progresit dhe përdorimi i gjetjeve

Progresi në zbatimin e strategjisë do të monitorohet në përputhje me sistemin e krijuar të monitorimit, vlerësimit dhe të nxënimit organizativ.



Të dhënat për rezultatet e arritura, përgjigjet institucionale, përvojat e qytetarëve, funksionimin e partneriteteve dhe kapacitetet organizative do të përdoren për:

- përshtatjen e planeve vjetore;
- përmirësimin e qasjeve programore;
- vendimmarrjen për vazhdimin, ndryshimin ose përfundimin e aktiviteteve të caktuara;
- shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare;
- komunikimin e rezultateve me komunitetet, partnerët dhe donatorët.

Monitorimi nuk do të kufizohet vetëm në përcaktimin nëse aktivitetet janë zbatuar, por do të vlerësohet edhe nëse ato kanë sjellë rezultatet e pritshme dhe ndryshimet në të cilat ka kontribuar ACDC.

10.6. Menaxhimi i rreziqeve dhe përshtatja

Zbatimi i strategjisë do të zhvillohet në një mjedis në të cilin tensionet politike, krizat e sigurisë, ndryshimet institucionale, marrëdhëniet ndëretnike dhe ndryshimet e prioritetëve të donatorëve mund të ndikojnë ndjeshëm në punën e planifikuar.

ACDC do të monitorojë rregullisht rreziqet që lidhen me:

- situatën politike dhe të sigurisë;
- disponueshmërinë dhe gatishmërinë e institucioneve për bashkëpunim;
- marrëdhëniet ndëretnike dhe hapësirën për pjesëmarrje publike;
- tensionet dhe presionet politike;
- sigurinë e punonjësve, bashkëpunëtorëve dhe pjesëmarrësve;
- stabilitetin financiar dhe disponueshmërinë e fondeve;
- mbingarkesën ose largimin e anëtarëve të ekipit;
- mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe personale;
- reputacionin dhe besimin e komuniteteve.

Për programet më të rëndësishme dhe planet vjetore të veprimit do të vlerësohen rreziqet kryesore dhe do të përcaktohen masat për zbutjen e tyre.

Kur rrethanat të ndryshojnë ndjeshëm, ACDC mund t'i përshtatë aktivitetet, afatet, formatet dhe partneritetet. Ndryshimet e tilla do të dokumentohen dhe arsyetohen. Objektivat strategjike dhe specifike do të ndryshohen vetëm kur ekzistojnë dëshmi të qarta se nevojat e komuniteteve, kushtet e punës ose kapacitetet e organizatës kanë ndryshuar në atë masë sa kërkohet një rishikim më i gjerë i strategjisë.

10.7. Rishikimi vjetor, afatmesëm dhe përfundimtar

Progresi në zbatimin e strategjisë do të shqyrtohet zyrtarisht një herë në vit, në kuadër të rishikimit të rezultateve të vitit të mëparshëm dhe përgatitjes së planit të veprimit dhe buxhetit për vitin e ardhshëm.

Rishikimi vjetor do të përfshijë shqyrtimin e:



- progresit drejt rezultateve strategjike dhe vjetore;
- prioriteteve të realizuara dhe të parealizuara;
- të dhënave dhe mësimave të nxjerra nga sistemi MEL;
- ndryshimeve në nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve;
- ndryshimeve në mjedisin e jashtëm;
- kapaciteteve organizative dhe financiare;
- rreziqeve kryesore dhe përshtatjeve të nevojshme.

Në mesin e periudhës strategjike do të realizohet një rishikim më gjithëpërfshirës, përmes të cilit do të vlerësohen rëndësia e objektivave strategjikë, progresi drejt rezultateve të pritshme, cilësia e qasjeve programore, qëndrueshmëria financiare dhe organizative dhe nevoja për përshtatjen e prioriteteve ose masave.

Në fund të periudhës së vlefshmërisë së strategjisë do të realizohet një vlerësim përfundimtar i rezultateve dhe kontributit në ndryshimet e arritura. Gjetjet e tij do të përbëjnë bazën për hartimin e dokumentit të ardhshëm strategjik.

10.8. Rezultati i pritshëm i zbatimit

Strategjia do të integrohet në planifikimin vjetor, zhvillimin e projekteve, përzgjedhjen e partneriteteve, shpërndarjen e burimeve dhe monitorimin e rezultateve të ACDC-së.

Vendimet programore dhe organizative do të lidhen në mënyrë më të qëndrueshme me misionin, objektivat strategjikë dhe nevojat e komuniteteve. Planet vjetore do të mundësojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve në mjedis pa e humbur drejtimin strategjik afatgjatë..



Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga programi „EJA Kosovo“ i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), i bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC) dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.

